



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 03/L-080

**PËR NDRYSHIMIN E LIGJIT TË KUVENDIT TË KOSOVËS 2004/9 MBI
RREGULLATORIN E ENERGJISË**

Kuvendi i **Republikës së Kosovës**,

Duke marrë parasysh Ligjin e Kuvendit të Kosovës 2004/9 Mbi Rregullatorin e Energjisë ("Ligji")

Duke marrë parasysh nevojën për të ndryshuar Ligjin në mënyrë që arrihet pajtueshmëri me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe instrumentët tjerë relevantë,

Miraton këtë

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN E LIGJIT TË KUVENDIT TË KOSOVËS 2004/9 MBI
RREGULLATORIN E ENERGJISË**

Neni 1

Teksti i tërë pjesës hyrëse të Ligjit të zëvendësohet me formulimin në vijim:

"Kuvendi i **Republikës së Kosovës**,

Në bazë të kompetencave të dhëna nga neni 65. 119.5 dhe 142 i Kushtetutës së **Republikës së Kosovës**;

Duke parë nevojën për themelimin e organit rregullativ të pavarur për sektorin e energjisë për tu siguruar konsumatorëve të Kosovës energji të qëndrueshme, të sigurt duke mos dëmtuar mjedisin, dhe për të themeluar, promovojë dhe mbrojnë tregun e lirë dhe konkurrues të energjisë që bazohet në parime objektive, transparente dhe jo-diskriminuese;

Miraton në vijim

LIGJ PËR RREGULLATORIN E ENERGJISË

Neni 2

Neni 4.1 i Ligjit të zëvendësohet në tërësi me nenin 4.1 në vijim:

4.1. Zyra e Rregullatorit për Energji themelohet me këtë ligj si një organ rregullator i pavarur në bazë të nenit 119.5 të Kushtetutës me qendër në Prishtinë për rregullimin e aktiviteteve në sektorin e energjisë në Kosovë.

Neni 3

Neni 5.2 i Ligjit të zëvendësohet në tërësi me nenin 5.2 në vijim:

5.2. Anëtarët të Bordit do të propozohen nga Qeveria dhe do të emërohen nga Kuvendi

Neni 4

Nenet 5.3, 5.4, 5.5 dhe 5.6 të Ligjit të zëvendësohen në tërësi me nenin 5.3 në vijim:

5.3. Mandati i secilit anëtar të Bordit do të jetë nga pesë vite.

Neni 5

Neni 5.7 i Ligjit të zëvendësohet në tërësi me nenin 5.4 në vijim:

5.4 Çdo anëtar i Bordit, mund të riemërohet edhe për një mandat tjetër pesë vjeçar.

Neni 6

Neni 6.1 i Ligjit të zëvendësohet në tërësi me nenin 6.1 në vijim:

6.1 Të gjithë anëtarët e Bordit do të jenë banorë (shtetas) të Kosovës.

Neni 7

Nenin 8.2 i Ligjit të zëvendësohet në tërësi me nenin 8.2 në vijim:

8.2. Anëtarët e Bordit do të paguhen me rroga mujore dhe mëditje udhëtimi apo mëditje të tjera të përcaktuara nga Kuvendi me propozim të Bordit.

Neni 8

Në Nenin 8.3 të Ligjit, të fshihet shprehja "që janë banorë të Kosovës."

Neni 9

Neni 8.4 i Ligjit të fshihet tërësisht.

Neni 10

Neni 8.5 i Ligjit rinumërohet në mënyrën adekuate.

Neni 11

Në nenin 10 të Ligjit, të fshihet shprehja "PSSP-së" .

Neni 12

Në nenin 10 (e) të Ligjit, të fshihet shprehja "dhe PSSP-së."

Neni 12. B

Neni 19 (c) i Ligjit zëvendësohet me formulimin në vijim "nëse është e nevojshme, përvetësimet buxhetore nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, në përputhje me ligjet në fuqi".

Neni 13

Neni 20.2 i Ligjit të zëvendësohet në tërësi me nenin 20.2 në vijim:

20.2. Të gjitha të hyrat e mbledhura nga Zyra e Rregullatorit për Energji depozitohen sipas rregullave të përcaktuara në Ligjin për Menaxhimin e Financave dhe Përgjegjësisë dhe ligjet në fuqi që rregullojnë kontabilitetin në Kosovë.

Neni 13 B

Në nenin 25.1 të Ligjit, fjala “katër” zëvendësohet me fjalën “tre”.

Neni 14

Në nenin 49.6 të Ligjit, të zëvendësohet shprehja "rregullore të UNMIK" me fjalën "legjislacion".

Neni 15

Kreu 16 i Ligjit të zëvendësohet në tërësi me Kreun 16 në vijim:

Neni 16

Ky Ligj hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/L-080
13 qershor 2008

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Jakup KRASNIQI